

SHQIPTARËT DHE NDËRKOMBËTARËT NË VITET 1912 – 1926

AKTE TË KONFERENCËS SHKENCORE

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË
INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” – PRISHTINË

Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926

Akte të Konferencës
Shkencore
(25 tetor 2019)

Përgatitja dhe redaktimi
Prof. asoc. dr. LEDIA DUSHKU

Tiranë, 2021

SHQIPTARËT DHE NDËRKOMBËTARËT
NË VITET 1912-1926
Akte të Konferencës Shkencore
(25 tetor 2019)

Përgatitja dhe redaktimi: **Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU**

Komiteti Shkencor i konferencës:

Akad. prof. dr. Beqir META - *Drejtues shkencor*

Prof. dr. Sabit SYLA

Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU - *Koordinator shkencor*

Dr. Sali KADRIA

Korrektore letrare: Mimoza KONOMI

Treguesi i emrave, Përkujdesja grafike: Mirela MIHALI

Kopertina: Dorina MUKA

ISBN 978-9928-289-63-6

© Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA) / Instituti i Historisë
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Botimet Albanologjike
Tiranë, 2021

Pasqyra e lëndës

Pak fjalë për lexuesin.....	7
I. Shqiptarët dhe ndërkombëtarët nga Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në vitet e Luftës së Parë Botërore.....	13
BEQIR META	
Vlerësimet britanike për procesin e shtetndërtimit në Shqipëri (1912-1926).....	15
ARDITA HAJDARI-BUQINCA, MIFTAR KURTI	
Shtypi francez për veprimtarinë e Hasan Prishtinës në vitin 1912..	25
LEDIA DUSHKU	
Pariteti austro-hungaro-italian, Banka Kombëtare Shqiptare dhe Fuqitë e Mëdha (1913-1914).....	35
ERARBA ÇIRAKU	
Shqipëria dhe shqiptarët në raportet diplomatike italiane (1913-1914).....	49
FATMIRA RAMA	
Qeverisja ndërkombëtare e Shkodrës dhe qeveria e Wilhelm Wied-it nën optikën e dokumenteve austro-hungareze	67
BUJAR DUGOLLI	
Principata shqiptare e Wilhelm Wied-it dhe Fuqitë e Mëdha	93
SYLË UKSHINI	
Kosova në kontekstin e Luftës së Parë Botërore	103

FITIM RIFATI

Kosova në sfondin e marrëdhënieve austro-hungareze e bullgare
(1915-1918)..... 139

II. Sfidat e shtetit shqiptar dhe marrëdhëniet me ndërkombëtarët (1919-1926)

MARENGLLEN VERLI

Diplomacia e Fuqive të Mëdha dhe sfida e shqiptarëve në janar 1920
..... 157

ALBANA MEMA

Institucionet e shtetit shqiptar në optikën e përfaqësuesve britanikë
dhe italianë në Shqipëri (1920-1924) 169

BRENDON SALIH

Shqipëria në dëshmitë e ndërkombëtarëve (1920-1926)..... 187

PRANVERA TELI (DIBRA)

Angazhimi i Harry Eyres në politikat e brendshme të konsolidimit
të shtetit shqiptar, 1921-1925..... 203

SALI KADRIA

Shqipëria dhe rivaliteti italo-jugosllav gjatë viteve 1922-1923 225

ARMEND MEHMETI

Qasja britanike për hapat e parë të Republikës Shqiptare 243

Treguesi i emrave.....257

Pak fjalë për lexuesin

Vitet 1912-1926 karakterizohen nga ngjarje, dukuri dhe personalitete historike, të cilat, në rrugëtimin e tyre tejet kompleks, i bënë shqiptarët subjekt të koniunkturave gjeopolitike të kohës. Që prej Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 faktori ndërkombëtar ndikoi dukshëm në formësimin strukturor të shtetit shqiptar, të paktën deri në vitin 1926, kur Komisionet Ndërkombëtare të Kufijve morën edhe vendimet përfundimtare për kufijtë shtetërorë. Fuqitë e Mëdha ushtruan ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë në krijimin dhe, më tej, në procesin e shtetndërtimit shqiptar, sipas shembullit të konsoliduar të shteteve rishtare, të vogla e politikisht të brishta të Ballkanit, të cilat mbijetuan edhe falë mbështetjes së Fuqive të Mëdha. Si shtet ballkanik i krijuar më vonë se të tjerët, Shqipëria u përball sa me rivalitetin e Fuqive të Mëdha, aq edhe me presione, ndërhyrje politike dhe ushtarake të shteteve fqinje, çka hera-herës e bëri mbijetesën edhe më të vështirë, madje edhe të pasigurt. Në të tillë situatë, roli i Të Mëdhenjve rezultoi të ishte vendimtar në marrëdhëniet e shqiptarëve me fqinjët. Rruga e mbijetesës dhe e konsolidimit të shtetit shqiptar kaloi përmes sfidave dhe dilemave të shumta edhe me vetveten. Zhvillimet e brendshme qenë shpeshherë turbulluese dhe me ndikim negativ në procesin e shtetndërtimit, duke i krijuar hapësira Fuqive të Mëdha të bënin edhe arbitrin në konfliktet politike të shqiptarëve.

Botimi *Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926* është produkti final i akteve të konferencës shkencore, organizuar si një sipërmarrje e përbashkët e Institutit të Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë me Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Konferenca e mbajtur në ambientet e Akademisë së Shkencave, më 25 tetor 2019, mori shkas nga dy jubile: 105-vjetori i krijimit të Principatës Shqiptare të Wilhelm von Wied (1914) dhe 100-

vjetori i fillimit të punimeve të Konferencës së Paqes në Paris (1919). Ajo analizoi momente të rëndësishme të historisë së shqiptarëve dhe qëndrimin e mbajtur nga Fuqitë e Mëdha; inxhinierinë e kufijve të shtetit shqiptar dhe ndërveprimin e Të Mëdhenjve; procesin e shtetndërtimit në Shqipëri dhe bashkëpunimin me Fuqitë e Mëdha; zhvillimet e brendshme politike, qëndrimin dhe rolin e ndërkombëtarëve; elitat politike shqiptare dhe marrëdhëniet me Fuqitë e Mëdha, pa lënë mënjanë edhe perceptimin që ndërkombëtarët kishin për Shqipërinë dhe shqiptarët në vitet 1912-1926.

Përmbledhja e paraqitur përmban një numër më të vogël studimesh, krahasuar me ato që u paraqitën gjatë ditëve të konferencës. Fillimisht prezantimet u ripunuan nga autorët në përputhje me kriteret e botimit, e më tej iu nënshtruan redaktimit shkencor e korrekturës letrare nga ekipi që punoi me to. Pikëpamjet e autorëve janë respektuar, duke mos cenuar parimin bazë të lirisë akademike. Botimi është i pajisur me aparatën shkencor, me një bibliografi të përmbledhur në fund të çdo artikulli, si dhe me treguesin e emrave.

Përmbledhja e akteve të konferencës është konceptuar në dy pjesë, të cilat ndjekin rendin kronologjik. Pjesa e parë përfshin artikuj që kanë në fokus të tematikës së tyre periudhën 1912-1918, ndërsa e dyta harkun kohor të viteve 1919-1926.

Punimi hapet me artikullin e akademik Beqir Metës, i cili ka në qendër rolin e rëndësishëm që Britania e Madhe ka luajtur kundrejt Pavarësisë së Shqipërisë dhe procesit të shtetndërtimit. Qëllimi i shprehur synon analizimin e pikëpamjeve të diplomacisë britanike, në një proces evolutiv përgjatë viteve 1912-1926. Analiza bëhet në dy nivele: niveli qendror, që trajton interesat gjeopolitike britanike, si edhe ai periferik, i cili pasqyron përimitimin që qeveria dhe përfaqësuesit britanikë i kanë bërë situatës së brendshme dhe grupeve politike, aftësive shtetformuese dhe shoqërisë shqiptare.

Studiuesit nga Kosova, Ardita Hajdari-Buqinca dhe Miftar Kurti vijnë me një parashtrësë ku trajtohet veprimtaria e Hasan Prishtinës në faqet e shtypit francez. Autorët kanë nxjerrë në pah me kujdes vëmendjen që shtypi francez i ka kushtuar veprimtarisë së Hasan Prishtinës, duke zbuluar arsyet e një qëndrimi të tillë. Artikulli jep të dhëna me interes për rolin dhe ndikimin e H. Prishtinës në zhvillimet politike dhe ushtarake gjatë vitit 1912, duke u fokusuar në ngjarjet e ndodhura në vilajetet e Rumelisë dhe në veçanti në atë të Kosovës e të Shkodrës.

Në artikullin e saj, studiuesja Ledia Dushku vë në qendër paritetin austro-hungaro-italian, krijimin prej tyre të Bankës Kombëtare Shqiptare si një sipërmarrje në bashkëpunim me Qeverinë e Përkohshme të Vlorës dhe qëndrimin e mbajtur nga Fuqitë e Mëdha. Artikulli trajton hap pas hapi procesin sesi Austro-Hungaria u shndërrua nga fuqi rivale në fuqi aleate me Italinë, parimet mbi të cilat u ngrit marrëdhënia dypalëshe ekonomike në rastin e Bankës Kombëtare Shqiptare dhe mënyrën si u prit krijimi i kësaj të fundit nga Fuqitë e Antantës, duke sjellë në vëmendjen e lexuesit gjithë procesin ndërveprues mes Të Mëdhenjve.

Artikulli i Erarba Çirakut fokusohet në vizionin dhe perceptimin e diplomatëve italianë rreth ngjarjeve që finalizuan Shpalljen e Pavarësisë, krijimin e funksionimit të shtetit të ri shqiptar. Dokumentet e Arkivit të Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane, të cilat përdoren për herë të parë, i krijojnë mundësi lexuesit për të kuptuar në mënyrë më të gjerë panoramën e zhvillimit të ngjarjeve, në vitet tejet intensive të historisë së shqiptarëve, 1912-1914. Artikulli hedh dritë në aspekte që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Ismail Qemal Vlorës dhe marrëdhëniet e tij me Fuqitë e Mëdha; zhvillimet politike e ushtarake në mbrojtje të Shkodrës, si edhe sjelljen e serbëve ndaj shqiptarëve.

Profesore Fatmira Rama sjell një qasje interesante në lidhje me qeverisjen ndërkombëtare të Shkodrës dhe raportet me qeverinë e Wilhelm von Wied-it në dritën e dokumentacionit austro-hungarez, i cili është pjesë e fondeve të Arkivit të Institutit të Historisë. Përmes analizës strukturore të këtij dokumentacioni, pasuruar edhe me bibliografinë përkatëse, lexuesi gjen të dhëna me interes në lidhje me natyrën e qeverisjes së Shkodrës në vitet e Principatës së Wilhelm von Wied-it; përpjekjet e rretheve të larta të politikës austro-hungareze për të siguruar një qeverisje të efektshme, pa lënë mënjanë edhe interesat e Mbretërisë Dualiste për krijimin e një ushtrie shqiptare dhe përfshirjen e detashmenteve ndërkombëtare në Shkodër.

Bujar Dugolli, profesor në Universitetin e Prishtinës parashton qëndrimin që Fuqitë e Mëdha mbajtën ndaj Principatës Shqiptare dhe të zgjedhurit të tyre, gjermanit të besimit protestant, Wilhelm von Wied. Artikulli evidenton sfidat e shumta me të cilat u përball shteti shqiptar në gjashtë muajt e vështirë të vitit 1914 dhe mënyrën si ndikoi qëndrimi i Fuqive të Mëdha në përballimin e tyre. Përmes literaturës së përdorur, vihet në dukje se pavarësisht nga ambiciet e Princ Wied-it për t'u kthyer në Shqipëri, ishin ndryshimet gjeostrategjike në Europën e pas Luftës

së Parë Botërore ato që prekën edhe interesat europiane për Principatën Shqiptare, duke i dhënë fund kështu ambicieve të Princit gjerman për të qeverisur shtetin shqiptar.

Studiuesi nga Kosova, Sylë Ukshini në artikullin e tij ndalet në vitet e Luftës së Parë Botërore dhe konkretisht zhvillimet në Kosovë. Ai analizon qëndrimin që Austro-Hungaria dhe Bullgaria mbajtën ndaj çështjes shqiptare, si edhe përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për të organizuar një kryengritje të përgjithshme antiserbe, në bashkëpunim me austro-hungarezët. Në artikull janë trajtuar pritshmëritë e larta që shqiptarët kishin ndaj politikës austro-hungareze, duke e konsideruar këtë të fundit si çliruesin e tyre nga serbët; dëshira e fortë e Mbretërisë Dualiste për forcimin e pozicionit të saj në Ballkanin Jugor, nëpërmjet bashkëpunimit me shqiptarët e Kosovës dhe udhëheqësit e tyre, domosdoshmëri që vinte në rrethanat kur bashkëpunimi me palën bullgare mbeti në vazhdimësi mosbesues dhe problematik.

Periudha e Luftës së Parë Botërore vjen në këtë përmbledhje punimesh dhe me një artikull të dytë, i cili mban autorësinë e kolegut të Institutit të Historisë në Kosovë, Fitim Rifati. Në bosht të tij qëndron trajtimi i aleancave ushtarake politike të Fuqive Qendrore dhe përpjekjet e tyre për të tërhequr pas vetes aleatë. Vëmendja përqendrohet në përpjekjet e Austro-Hungarisë për të bërë pjesë të Aleancës Bullgarinë, humbëse e Luftës së Dytë Ballkanike dhe e pakënaqur me shtrirjen e saj territoriale. Në tërësi, artikulli analizon procesin e përfshirjes së Kosovës në kuadër të marrëdhënieve politike, ushtarake e administrative ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Bullgarisë gjatë viteve 1915-1918.

Pjesa e dytë e punimit u kushtohet marrëdhënieve mes shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve në vitet 1919-1926. Diplomacia e Fuqive të Mëdha dhe sfida e shqiptarëve në Konferencën e Paqes sillen në vëmendjen e lexuesit në artikullin e akademik Marenglen Verlit. Në dy rrafshë paralele trajtohen qëndrimi i Fuqive Fituese, të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre sa i përket “çështjes shqiptare”, si edhe përpjekjet e shqiptarëve për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për shtetin e tyre. Akademik Verli, përmes literaturës së përdorur, zbulon arsyet të cilat çuan në përfundimin e pritshëm nga shqiptarët, që nga qëndrimi i SHBA-së dhe këmbëngulja personale e Presidentit amerikan, W. Wilson, deri te kundërshtimi jugosllav ndaj projektit franko-britanik dhe organizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare brenda vendit.

Brendon Salih, i cili ka kryer studimet master në Universitetin e Strasburgut (Francë), ka në fokus të artikullit të tij dëshmitë dhe perceptimin e të huajve që e kanë vizituar, punuar apo “lobuar” për interesat e Shqipërisë. Korpusi i burimeve të përdorura mbështetet kryesisht në kujtimet e publikuara dhe raportet e misioneve ndërkombëtare, duke u ndalur veçanërisht në raportin e profesorit luksemburgas, Calmes. Në tërësi, artikulli ka një qasje socio-ekonomike, i fokusuar te shkëmbimet tregtare, potencialet ekonomike, burimet natyrore dhe përparësitë e zhvillimit të shtetit të ri ballkanik në rrugën drejt përparimit. Ai plotëson një boshllëk të krijuar në studimet e derisotme shqiptare, të cilat janë përqendruar kryesisht në aspekte të ndryshme të historisë politike.

Artikulli i koleges Albana Mema parashtron ecurinë e institucioneve të shtetit shqiptar, parë në optikën e përfaqësuesve britanikë dhe italianë në Shqipëri. Fokusi i tij janë vitet 1920-1924, vite tejet intensive sa u përket zhvillimeve politike, të cilat ndikuan edhe në ecurinë e brishtë të jetës institucionale në Shqipëri. Sikurse edhe vetë titulli e përcakton, artikulli vë në një qasje paralele mënyrën sesi britanikët dhe italianët i shohin institucionet politike shqiptare. Ai evidenton qartë, se duke nisur nga fillimi i vitit 1920 institucionet e reja dhe tepër të dobëta qeverisëse shqiptare, ishin nën vëzhgimin e Britanisë së Madhe, e cila, ndryshe nga Italia, nuk qe sfiduese e tyre. Autorja arrin në përfundimin se kjo pozitë e shtetit britanik, mbajti në pozicion të tërhequr Italinë dhe fqinjët ballkanikë të Shqipërisë, të cilët ajo i konsideron si kundërshtarët dhe rrezikun më të madh për shtetin shqiptar dhe institucionet e tij.

Në përpjekjet e klasës politike të kohës për të eksperimentuar modelet perëndimore të demokracisë liberale në një terren politik të vështirë ku trashëgimia osmane ishte e pranishme në mënyrën e të menduarit dhe të vepruarit në shoqërinë shqiptare, spikati figura e diplomatit anglez Harry Eyres. Angazhimi i tij në politikën e brendshme për konsolidimin e shtetit shqiptar në vitet 1921-1925, kohë kur ai ishte ministër i Britanisë së Madhe në Shqipëri, trajtohen në artikullin e studiueses Pranvera Teli (Dibra). Përmes përdorimit të burimeve parësore, artikulli argumenton qartë se H. Eyres, në ndjekje të realizimit të interesave kombëtarë të vendit që përfaqësonte, ndërhyri në jetën e brendshme politike të shtetit shqiptar duke siguruar mbijetesën e tij politike përmes kurtheve të krijuara nga faktorë të brendshëm e të jashtëm.

Artikulli i kolegut të Institutit të Historisë Sali Kadria analizon pozitën e Shqipërisë dhe rivalitetin italo-jugosllav gjatë viteve 1921-1923. Nevoja e forcimit të pozitës ndërkombëtare të shtetit shqiptar, si dhe nxitja e shkëmbimeve ekonomike me vendet fqinjë ishin dy arsyt që i orientuan drejtuesit e shtetit shqiptar drejt Italisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Përmes qasjes krahasimore, artikulli evidenton arsyet pse Italia dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene ishin dy shtetet më të interesuara për çështjen shqiptare; pse Italia nuk arriti të ndërtonte një politikë të besueshme në marrëdhëniet me shtetin shqiptar; cilët ishin faktorët që kushtëzuan marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe si ndikoi në këtë drejtim prirja e marrëdhënieve me Italinë.

Armend Mehmeti, studiues në Institutin e Historisë në Kosovë, në artikullin e tij “Qasja britanike ndaj hapave të parë të Republikës Shqiptare” e fokuson analizën në zhvillimet e brendshme në Shqipëri në aspekt të hartimit të legjislacionit, si edhe të reformave në sferën shoqërore e ekonomike, krijimin e xhandarmërisë, veprimet e kreut të shtetit për të siguruar qetësinë e brendshme, rolin e ministrit britanik, Harry Eyres në pasqyrimin e këtyre zhvillimeve dhe reagimin e Ministrisë Britanike të Punëve të Jashtme në çështjet e cekura më lart.

Së fundmi, dëshiroj t’u shpreh falënderime studiuesve që i përgjigjën thirrjes sonë për zhvillimin e konferencës, për prezantimet e paraqitura, pjesëmarrjen aktive në të gjithë debatin e ndjekur dhe, më tej, për botimin e akteve të saj. Puna ime nuk do të kishte pasur këtë rezultat pa profesionalizmin dhe bashkëpunimin e Komitetit Shkencor të konferencës, akademikut Beqir Meta, profesorit Sabit Syla dhe doktorit Sali Kadria. U jam mirënjohëse për kontributin e tyre. Një falënderim i ndier shkon edhe për kolegët e Institutit të Historisë dhe të Departamentit të Historisë së Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar, për mbështetjen e tyre vazhdueshme. Po ashtu, i detyrohem thellësisht Mirela Mihalit, Mimoza Konomit, Meliha Ballës, Dorina Mukës dhe Marsela Metës për ndihmën e vyer që botimi të merrte formën e tij të plotë.

Prof. asoc. dr. Ledia Dushku
Tiranë, shtator 2021